



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16 Mars 2021

Nr: 145

**VENDIM**

**PËR REGJISTRIMIN E Z. BOIKEN XHELAL ABAZI SI KANDIDAT I PROPOZUAR NGA  
ZGJEDHËSIT PËR DEPUTET, NË ZONËN ZGJEDHORE QARKU TIRANË, PËR  
ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 69, 71, 72 e 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga komiteti nismëtar për regjistrimin e z. Boiken Xhelal Abazi si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për deputet, në zonën zgjedhore qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021,

**V Ë R E J:**

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 63, datë 11.02.2021 ka regjistruar komitetin nismëtar i cili do të organizojë punën për mbledhjen e firmave mbështetëse për paraqitjen e z. Boiken Xhelal Abazi si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për deputet, në zonën zgjedhore qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021.

Me shkresën nr. 976/1 prot., datë 26.02.2021, komiteti nismëtar ka paraqitur në KQZ nënshkrimet mbështetëse të 3744 (tremijë e shtatëqind e dyzetë e katër) zgjedhësve, për të cilët shprehet se janë të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë në zonën zgjedhore Qarku Tiranë.



Data: \_ Mars 2021

Nr. \_

Për regjistrimin e z. Boiken Xhelal Abazi si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për deputet, në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit për deputet, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, Qarku Tiranë; Model – 04;
2. Deklarata e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit për deputet se nuk është pjesë e asnjë partie apo koalicioni dhe nuk do të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë, ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurren në zgjedhje, Model - 05;
3. Listat e zgjedhësve të zonës zgjedhore që mbështesin kandidatin të nënshkruar prej tyre sipas Modelit - 06, së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit;
4. Jetëshkrimi i kandidatit Model – 07;
5. Formulari i vetëdeklarimit.

Në mbështetje të nenit 71, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 7, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, Komisioneri ftoi komitetin nismëtar, për të qenë prezent në seancën publike për verifikimin e numrit të nënshkrimeve.

Neni 69 pika 3 përcakton se Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për deputet vetëm në rast se ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon jo më pak se 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por në çdo rast jo më shumë se 3000 (tre mijë) zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Referuar ekstraktit më të fundit të listës së zgjedhësve rezulton se Qarku Tiranë ka 910 325 zgjedhës. Sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 69 të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, numri i zgjedhësve që i korrespondon kufirit minimal prej 1% të listës së 910 325 zgjedhësve të zonës zgjedhore Tiranë është 3 000 (tre mijë) zgjedhës.

Administrata e KQZ-së verifikoi nënshkrimet e zgjedhësve në listat mbështetëse për Qarkun Tiranë për të cilat rezultoi se gjithsej janë dorëzuar 3744 (tre mijë e shtatëqind e dyzetë e katër) nënshkrime të plotësuara sipas modelit 06. Për çdo zgjedhës në listë bashkëlidhur është depozituar dhe kopje e letërnjoftimit e nënshkruar prej tyre.

Në bazë të nenit 71, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nga Administrata e KQZ është bërë verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar duke përzgjedhur në mënyrë rastësore 5% të zgjedhësve nga lista e zgjedhësve mbështetës. Numri i zgjedhësve të verifikuar është 150.



Në përfundim, nga verifikimi i nënshkrimeve të depozituara nga zgjedhësit mbështetës rezulton se numri i zgjedhësve që kanë nënshkruar në listën mbështetese duke përjashtuar numrin e nënshkrimeve të parregullta është më i madh se numri minimal i kërkuar për nënshkrimet në bazë të nenit 70, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Referuar ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat për deputet.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit, nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, kandidati i propozuar nga zgjedhësit për deputet, z. Boiken Xhelal Abazi ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 013, datë 26.02.2021, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi konstatoi se pikat 1, 2 dhe 3 të formularit të vetëdeklarimit ishin të paplotësuara, me shkresën nr. 1704 prot., datë 06.03.2021, me lëndë kërkesë për plotësim dokumentacioni, në përputhje me Kreun II, pika 6 dhe 7 të vendimit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, i kërkoi z. Boiken Xhelal Abazi ridepozitimin e formularit të vetëdeklarimit pa të meta, brenda 5 (pesë) ditëve.

Z. Boiken Xhelal Abazi më datë 08.03.2021 ridepozitoi formularin e vetëdeklarimit me numër 013/1 unik, të plotësuar sipas parashikimeve të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit të propozuar nga zgjedhësit për deputet, z. Boiken Xhelal Abazi, në qarku Tiranë, rezulton se, në rubrikën III, “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”,,

**PIKA 1**, “*A jeni dënuar ndonëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO” duke deklaruar se:

- Siç e ka shpjeguar edhe në formularin e parë të dorëzuar në KQZ në datën 26 shkurt 2021, nuk ka informacion zyrtar nga autoritetet e Kosovës (për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari ) edhe pse këtë gjë e ka kërkuar prej autoriteteve të Kosovës. Por i gjithë aktiviteti i tij ka qenë publik në Kosovë dhe i lidhur me organizimet politike të Lëvizjes VETËVENDOSJE! Për shkak të shkresës së KQZ-së në Shqipëri, data 6 mars 2021, ku i është kërkuar të plotësojë



këtë pjesë të formularit të dekriminalizimit pavarësisht mungesës së informacionit zyrtar nga autoritetet e Kosovës, atëherë në bazë të hulumtimit që ka bërë të raportimeve mediatike (<https://kosovalb.com/2012/10/17/protesta-e-vv-emrat-e-62-te-arrestuarve/>), memories së tij, dhe diskutimit me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, subjekti vetëdeklarues deklaroi se më 17 tetor 2012, janë ndaluar nga Policia e Kosovës 62 aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE!. Për shkak të pjesëmarrjes në organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, ku kundërshtojë nënshkrimi i marrëveshjes për privatizimin e Kompanisë Publike të Kosovës për Distribucionin për Furnizim me Energji Elektrike. Mes aktivistëve të ndaluar nga policia ka qenë edhe z.Boiken Xhelal Abazi i cili ka bindjen se shumica e aktivistëve të ndaluar janë proceduar nga “Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë”.Në këtë rast z.Boiken Xhelal Abazi beson se e njëjta gjykatë e sipërpërmendur ka proceduar edhe rastin e tij bashkë me aktivistë të tjerë.

- Në bazë të vendimit të datës 17 tetor 2012, vepra penale për të cilën është dënuar është kundërvajtje me gjobë, në shumën 450 (katërqind e pesëdhjetë) Euro, referuar Nenit 16 të ligjit mbi rendin dhe qetësinë publike” në Republikën e Kosovës.Nuk ka patur masë dënimi me burg, dhe z. Abazi është liruar brënda ditës. Në dijeninë e z. Boiken Xhelal Abazi, gjoba është paguar. Z.Abazi në formularin e vetëdeklarimit ka deklaruar gjithashtu se nuk ka numër vendimi për rastin e tij. Por një nga vendimet që u mor atë ditë ndaj aktivistëve të Lëvizjes VETËVENDOSJE! nga Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, ka numrin e rregjistrimit si në vijim : 46450/2012. Në bazë të këtij numri, autoritetet do mund të gjenin edhe numrin për ndonjë vendim të marrë ndaj z. Abazi në po atë ditë nga Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë. Z Boiken Xhelal Abazi nuk është në dijeni që ekziston ndonjë tjetër lloj vendimi ndaj tij që lidhet me këtë rast.
- Gjithashtu subjekti vetëdeklarues në formularin e vetëdeklarimit ka deklaruar se nuk është në dijeni për ndonjë tjetër rast dënimi nga gjykatat në shtetet ku ka jetuar apo që ka vizituar. E vetmja situatë e paqartë lidhet me Kosovën, për shkak të angazhimit të tij politik me Lëvizjen VETËVENDOSJE! në Kosovë, dhe për shkak se autoritetet e Kosovës kanë refuzuar që ti japin informacion zyrtar. Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të formularit të vetëdeklarimit. Z. Boiken Xhelal Abazi në formularin e vetëdeklarimit ka deklaruar se nuk i është dhënë informacion nga organet kompetente në Kosovë, edhe pse këtë gjë ai e ka kërkuar.
- Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari. z. Abazi ka deklaruar se në dijeninë e tij nuk është dënuar me burgim askund. Ai e viziton Kosovën rregullisht, zyrtarisht dhe publikisht dhe se nuk është ndaluar nga policia për ndonjë masë dënimi me burg dhe nuk i është dhënë nga Policia e Kosovës apo e një shteti tjetër informacion nëse është dënuar ndonjëherë me burgim. Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari.Nuk i është dhënë



informacion nga organet kompetente në Kosovë. Për më shumë, referojuni sqarimit në fund të këtij formulari.

**PIKA 2,** “*A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*”, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “JO” duke deklaruar se:

- Në dijeninë e tij nuk është dënuar me burg në asnjë shtet ku ka jetuar apo që ka vizituar. E vetnja situatë e paqartë lidhet me Kosovën, për shkak të angazhimit të tij politik me Lëvizjen VETËVENDOSJE! në Kosovë, dhe për shkak se autoritetet e Kosovës kanë refuzuar që ti japin informacion zyrtar. Megjithatë z. Abazi e viziton Kosovën rregullisht, publikisht dhe zyrtarisht, dhe nuk është njoftuar nga organet kompetente për raste të tilla. Për më tepër, referojuni sqarimit në fund të formularit të vetëdeklarimit.

Z. Boiken Xhelal Abazi ka deklaruar se nuk i është dhënë informacion nga organet kompetente në Kosovë. Për më tepër referojuni sqarimit në fund të këtij formulari.

**PIKA 3** “*A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO” duke deklaruar

- Rastet për të cilat mund të ketë qenë në hetim ose gjykim në një shtet tjetër jashtë Shqipërisë lidhen vetëm me Republikën e Kosovës dhe pjesëmarrjen e tij në organizimet politike të Lëvizjes VETËVENDOSJE! Në Kosovë. Nuk i është dhënë informacion zyrtar nga organet kompetente në Kosovë lidhur me këtë çështje edhe pse këtë gjë z. Abazi e ka kërkuar zyrtarisht ( Ju lutem t’i referoheni sqarimit në fund të formularit të vetëdeklarimit). Për shkak të shkresës së KQZ-së në Shqipëri, data 6 mars 2021, ku i është kërkuar që të plotësojë një pjesë të formularit të dekriminalizimit pavarësisht mungesës së informacionit zyrtar nga autoritetet e Kosovës, atëherë në këtë pjesë të formularit të vetëdeklarimit z. Abazi do të përfshijë 7 (shtatë) raste (përfshirë rastin e sqaruar më sipër në seksionin III, pika 1, faja 3 të formularit), në rend kronologjik, në bazë të hulumtimit që z. Abazi ka bërë, të raportimeve mediatike, kujtesës së tij, dhe diskutimit me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!. Ndërsa në lidhje me deportimin e tij nga Kosova, më datë 16 mars 2016, krejt të motivuar politikisht, rasti është shpjeguar më poshtë, në pyetjen 7 të formularit të vetëdeklarimit.
- **Rasti i parë** lidhet me organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE! Në Kosovë, të datës 3 shtator 2011, ku kundërshtoheshin koncesionet e vazhdueshme të Kosovës ndaj Serbisë në dialogun Kosovë-Serbi. Në këtë organizim politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE! U ndalen nga policia 35 aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, mes tyre edhe z. Boiken Xhelal Abazi.



- Organet proceduese duhet të kenë qënë Policia dhe Prokuroria e Republikës së Kosovës. Për arsye të pjesëmarrjes në organizimin e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, në Kosovë që kundërshtonte koncesionet e Kosovës ndaj Serbisë në dialogun Kosovë- Serbi, më datë 3 shtator 2011, në bazë të formularit të vetëdeklarimit rezultoi se bazuar mbi raportimet mediatike, memorien e z. Abazi dhe diskutimet me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, z. Boiken Xhelal Abazi është mbajtur në paraburgim rreth 48 orë, më tej është liruar dhe nuk është njoftuar më zyrtarisht për ecurinë e këtij rasti nga autoritetet e Republikës së Kosovës.
- **Rasti i dytë** lidhet me datën 14 janar 2012 dhe organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, të titulluar “Serbia nuk kalon”, në mbështetje të zbatimit të masave të reciprocitetit të Kosovës ndaj Serbisë. Në këtë organizim u ndalën nga Policia e Kosovës 146 aktivistë dhe deputetë të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, mes tyre edhe z. Boiken Xhelal Abazi. Organet proceduese duhet të kenë qënë Policia dhe Dheu i Bardhë, Gjilan dhe Prokuroria e Republikës së Kosovës, më datë 14 janar 2012, për arsye të pjesëmarrjes në organizimin e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, në mbështetje të zbatimit të masave të reciprocitetit të Kosovës ndaj Serbisë rezultoi se bazuar mbi raportimet mediatike, memorien e z. Abazi dhe diskutimet me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, z. Boiken Xhelal Abazi është mbajtur në paraburgim rreth 48 orë, më tej është liruar dhe nuk është njoftuar më zyrtarisht për ecurinë e këtij rasti nga autoritetet e Republikës së Kosovës.
- **Rasti i tretë** lidhet me datën 22 janar 2012 dhe organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, të titulluar sërish “Serbia nuk kalon” si vazhdimësi e organizimit të datës 14 janar 2012. Edhe më 22 janar 2012 organizimi ishte në mbështetje të zbatimit të masave të reciprocitetit të Kosovës ndaj Serbisë. Në këtë organizim u ndalën nga Policia e Kosovës 6 aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, qytetarë të Republikës së Shqipërisë, mes tyre edhe z. Boiken Xhelal Abazi. Organet proceduese duhet të kenë qënë Policia dhe Prokuroria e Republikës së Kosovës. Pika Kufitare e Kosovës, mes Kosovës dhe Shqipërisë në Morinë më datë 22 janar për arsye të pjesëmarrjes në organizimin e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në mbështetje të zbatimit të masave të reciprocitetit të Kosovës ndaj Serbisë. Policia e Kosovës ndali në kufi, në mënyrë arbitrare dhe pa urdhërarrest, qytetarë të Republikës së Shqipërisë që ishin nisur në solidaritet për të marrë pjesë në organizimin e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, në Kosovë. Bazuar mbi raportimet mediatike, kujtesës së z. Abazi dhe diskutimet me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, z. Boiken Xhelal Abazi është mbajtur rreth 1-2 orë, në paraburgim në Pikën Kufitare të Kosovës në Morinë. Më tej është liruar dhe nuk është njoftuar më zyrtarisht për ecurinë e këtij rasti nga autoritetet e Republikës së Kosovës. Pasi u lirua, Policia e Kosovës nuk e ndali hyrjen e z. Abazi në Republikën





e Kosovës dhe bashkë me qytetarë të tjerë të Republikës së Shqipërisë iu bashkuan organizimit politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, në Merdarë, Kosovë , në mbështetje zbatimit të masave të reciprocitetit ndaj Serbisë.

- **Rasti i katërt** është shpjeguar edhe më sipër , në seksionin III, pika 1, faqja 3 e formularit të vetëdeklarimit. Në bazë të hulumtimit që z. Abazi ka bërë, bazuar në raportimet mediatike, kujtesës së tij dhe diskutimit me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, z. Abazi deklaroi se më datë 17 tetor 2012, janë ndaluar nga Policia e Kosovës 62 aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, për shkak të pjesëmarrjes në organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, ku kundërshtojnë nënshkrimin e marrëveshjes për privatizimin e Kompanisë Publike të Kosovës për Distribucionin për Furnizimin me Energji Elektrike. Mes aktivistëve të ndaluar nga Policia ka qënë edhe z. Boiken Xhelal Abazi, i cili ka bindjen se shumica e aktivistëve janë proceduar nga “Gjykata Komunale” për Kundërvajtje në Prishtinë”. Në këtë rast z. Abazi beson se e njejta Gjykatë e sipërpërmendur ka proceduar edhe rastin e tij bashkë me aktivistë të tjerë. Më datë 17 tetor 2012, në bazë të nenit 16, Ligji mbi rendin dhe qetësinë publike në Republikën e Kosovës z. Boiken Xhelal Abazi është dënuar me Kundërvajtje – gjobë në shumën 450 (katërqind e pesëdhjetë ) Euro .Në dijeninë e z. Abazi, gjoba është paguar por jo nga ana e tij.
- **Rasti i pestë** lidhet me organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, në Prishtinë, Kosovë, për të kundërshtuar koncesionet e Kosovës ndaj Serbisë në dialogun Kosovë – Serbi. Të paktën 33 aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE janë ndaluar nga Policia e Kosovës në atë organizim ,midis tyre edhe z. Abazi. Organet proceduese duhet të kenë qënë policia dhe Prokuroria e Republikës së Kosovës. Më datë 22 tetor 2012, për arsye të pjesëmarrjes në organizimin e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në kundërshtim të koncesioneve të Kosovës ndaj Serbisë në dialogun Kosovë-Serbi rezultoi se bazuar mbi raportimet mediatike ,kujtesës së z. Abazi dhe diskutimet me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, z. Boiken Xhelal Abazi është mbajtur rreth 48 (dyzet e tetë) orë, në Kosovë, më tej është liruar dhe nuk është njoftuar më zyrtarisht për ecurinë e këtij rasti nga autoritetet e Republikës së Kosovës. Në dijeninë e tij, për këtë rast Lëvizja VETËVENDOSJE! ka dorëzuar edhe kallëzim penal kundër Policisë së Kosovës, për keqtrajtimin e qytetarëve gjatë organizimit politik dhe Brenda komisariateve të policisë.
- **Rasti i gjashtë** , lidhet me datën 12 tetor 2015, rreth orës 21:05, në afërsi të Prishtinës ku është ndaluar vetura e markës “Passat” me targa 01-917-HG. Në këtë veturë gjendej Albin Kurti, deputet i Kuvendit të Kosovës, z. Boiken Xhelal Abazi, Sekretar për Marrëdhëniet me Jashtë, z. Veton Dragusha, aktivist dhe z. Glauk Konjufca, deputet i Kuvendit të Kosovës. Atë natë (12 tetor 2015 ) janë ndaluar nga zyrtarët e Policisë së Kosovës, në afërsi të Prishtinës, të cilët i kanë nxjerrë në



menyrë të dhunshme nga automjeti, i kane vendosur prangat dhe më tej ne pranga, i kanë shoqëruar për në komisariat, në mënyrë të kundralighshme, në formë rrëmbimi, pa urdhër arresti të Prokurorisë Themelore në Prishtinë. E vetmja arsye pse mund të jetë ndalur z. Boiken Xhelal Abazi nga Policia e Kosovës është fakti se z. Abazi ka qënë duke udhëtuar në të njëjtin automjet me të cilin po udhëtonte edhe z. Albin Kurti. Organet proceduese duhet të kenë qënë Policia dhe Prokuroria e Republikës së Kosovës. Bazuar mbi raportimet mediatike, memorien e z. Abazi dhe diskutimet me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, z. Boiken Xhelal Abazi është mbajtur në paraburgim rreth 3 (tre) orë , në Prishtinë. Më tej është liruar dhe nuk është njoftuar zyrtarisht për ecurinë e këtij rasti nga autoritetet e Republikës së Kosovës. Në dijeninë e z. Abazi, për këtë rast, z. Albin Kurti ka dorëzuar edhe kallëzim penal kundër Policisë së Kosovës, për keqtrajtimin e personave të ndaluar atë ditë.

- **Rasti i shtatë** lidhet me organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, në kundërshtim të deklaratave të ministrit serb Aleksandar Jabllanoviç, që pati cilësuar si “egërsira” familjarët e personave të zhdukur në Gjakovë. Organizimi u zhvillua para selisë së Ministrisë për Kthim dhe Komunitete, në komunën e Fushë-Kosovës, ku kërkua shkarkimi i ministrit Jabllanoviç. Në këtë organizim politik Policia ndali 19 aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, mes tyre dhe z. Boiken Xhelal Abazi. Organet proceduese duhet të kenë qënë Policia dhe Prokuroria e Republikës së Kosovës. Më datë 16 janar 2015 për arsye të pjesëmarrjes të z. Abazi në organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE! Bazuar mbi raportin mediatik, dhe kujtesës së vetë subjektivitetit vetëdeklarues dhe diskutimet me koleget e Lëvizjes VETËVENDOSJE! Është mbajtur në paraburgim rreth 5 orë në komunën e Fushë-Kosovës. Më tej është liruar dhe nuk është njoftuar më zyrtarisht për ecurinë e këtij rasti nga autoritetet e Republikës së Kosovës.

**PIKA 4**, “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se :

- Nga data 17-20 Maj 2020, Policia e Shtetit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka ngritur ndaj z. Boiken Xhelal Abazi akuzat me dyshimin për kryerjen e këtyre veprave:
  - 1) Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik;
  - 2) Organizim dhe pjesëmarrje në grumbullim e manifestime të paligjshme;
  - 3) Pengim i qarkullimit të mjeteve të transportit.

Të gjitha keto akuza lidheshim me pjesëmarrjen e z. Boiken Xhelal Abazi në protestat paqësore të datës 17 maj 2020, ku kishte dalë bashkë me qytetarë të tjerë në mbrojtje të Teatrit Kombëtar, në Tiranë, Monument Kulture i cili u shemb nga autoritetet në shkelje të ligjit. E për këtë shkelje janë hapur raste gjyqësore ndaj autoriteteve të Republikës së Shqipërisë.





- Në seancën gjyqësore të mbajtur më datë 25 janar 2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur pushimin e të gjitha akuzave dhe shuarjen e masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”.
  - i) Më datë 20 tetor 2020, z. Boiken Xhelal Abazi është ndaluar nga Policia e Shtetit duke ecur në rrugë në drejtim të protestës qytetare paqësore që po mbahej para Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Gjithashtu është shoqëruar për më tej në Komisarariat.
  - ii) Z. Boiken Xhelal Abazi ka deklaruar se pasi është shoqëruar në Komisarariat është liruar po atë ditë nga Komisarariat, më datë 20 tetor 2020. Gjithashtu z. Boiken Xhelal Abazi ka deklaruar se me gjithë informacionin që disponon nuk di të jetë në hetime dhe nuk është në dijeni nëse janë ngritur ndaj tij akuza në lidhje me këtë rast.
  - iii) Gjithashtu Z.Boiken Xhelal Abazi deklaron që rastet që lidhen me angazhimin politik në Kosovë me Lëvizjen VETËVENDOSJE janë shpjeguar më lart në Pyetjen nr.3 në këtë formular .

**PIKA 5,** “*A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO” duke deklaruar masën shtrënguese të sigurisë “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” (revokuar).

- Në datën 20.05.2019 deri më 25.01.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka akuzuar për veprën penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, “Organizim dhe pjesëmarrja në grumbullim e manifestime të paligjshme”, “Pëngimi i qarkullimit të mjeteve të transportit”, në bazë të nenit 234 i Kodit të Procedurës Penale, nenit 262/2 dhe 236/2 i Kodit Penal. Të gjitha këto akuza lidheshin me pjesëmarrjen e z. Boiken Xhelal Abazi në pjesëmarrjen e protestës paqësore të datës 17 maj 2020, ku kishte dalë së bashku me qytetarë të tjerë në mbrojtje të Teatrit Kombëtar në Tiranë, Monument Kulture, i cili u shëmb nga autoritetet në shkelje të ligjit. Në vendimin përfundimtar, në seancën gjyqësore të mbajtur më datë 25 janar 2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pushimin e të gjitha akuzave dhe shuarjen e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.
- Z.Boiken Xhelal Abazi ka deklaruar që nuk i është dhënë informacion nga organet kompetente në Prishtinë,Kosovë edhe pse këtë gjë e ka kërkuar zyrtarisht.Referojuni sqarimit në fund të këtij formulari.

**PIKA 7,** “*A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO” .



- Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës , me nr. Reference 011/2016 ka dhënë masën e dëbimit për periudhën nga data 16 mars 2016 deri me 16 mars 2018 (2 vite ndalesë për hyrje). Z. Boiken Xhelal Abazi, ka deklaruar se masa ndaj tij ka qenë krejtësisht e motivuar politikisht nga organet e kapura të shtetit të Kosovës. Në masën për dëbimin e tij me forcë nga Kosova, të aktivizuar me 16 mars 2016 shkruhet se ishte ngarkuar me 5 (pesë) vepra penale nga autoritetet e Kosovës. Gjithashtu z. Abazi citon se po të ishte në hetim për 5 (pesë) vepra penale, atëherë do duheshin cuar në hetim për vepra penale zyrtarët që e kishin dëbuar nga Kosova. E nëse do ishte në hetim për vepra penale , atëherë do duhej ta conin në Gjykatë e jo ta dëbonin nga Kosova Fakti që dëshmon se nuk ka patur vepra penale dhe se ajo masë ka qënë krejtësisht e motivuar politikisht, është deklarata zyrtare dhe publik dhënë për mediat në datën 17 mars 2016 nga zëdhënësi i Policisë së Kosovës, z. Baki Kelani ,i cili ka deklaruar se “I njëjti (Boiken Abazi v.j)”, është larguar se ka kundërvajtje, e jo vepra penale. Aty në njëfarë mënyre është një gabim teknik i përvjedhur. Ndryshe, ai nuk ka vepra penale por vetëm kundërvajtje.
- z. Boiken Xhelal Abazi ka deklaruar gjithashtu se para këtij dëbimi nuk ka qënë kurrë i njoftuar as me shkrim as me gojë, nga Policia e Kosovës, për pretendimet e ngitura ndaj tij në masën e dëbimit me forcë nga Kosova. Zyrtari i autoriteteve të Kosovës i cili ka nënshkruar masën e dëbimit ndaj z. Abazi, nuk ka vendosur as emrin e tij në dokumentin e masës të ndërmarrë ndaj tij, por vetëm nënshkrimin, dhe identiteti i tij mbetet sot e kësaj dite i pavërtetuar. Bazuar mbi këto deklarata të Policisë (referojuni edhe sqarimit në fund të formularit të vetëdeklarimit) deri më sot, nuk ka asnjë dëshmi që të tregojë se z. Abazi është në hetim apo se është dënuar ndonjëherë për vepra penale në Kosovë sipas asaj që shkruhet në urdhërin e deportimit me forcë nga Kosova. Ka deklaruar që atë ditë është ndaluar nga 3 civilë që nuk e kanë lejuar të kontaktojë me një avokat, as me Ambasadën e Shqipërisë. Deklaron që është dërguar me një makinë të Policisë së Kosovës në zonën neutral mes kufirit Kosovë-Shqipëri në Morinë, pa i lajmëruar autoritetet e Republikës së Shqipërisë. Për më shumë referojuni sqarimit në fund të këtij formulari.

**PIKA 8,** “ *A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?*” subjekti deklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se,

- Në vitet 1993-1996 ka jetuar në Selanik, Greqi, për arsye Shkollim fillor (Klasa 6-8), në Kampusin e Kolegjit Anatolia Pineood Schools of Thessaloniki, Selanik, Greqi.
- Në vitet 1999-2000 ka jetuar në Green Forest Arkansas, SHBA, për arsye shkollimi (Viti IV-Gjimnaz) Program shkëmbimi, adresa e vendqëndrimit Familja Kupfersberger Green Forest,

Arkansas,72638 USA.

- Në vitet 2000-2004 ka jetuar në Ypsilanti, Michigan,SHBA, për arsye Praktika e Punës, adresa e vendqëndrimit Association for Eorld Travel Exchange 88 Street, Neë York,USA
- Në vitet 2010-2016 ka jetuar në Prishtinë, Kosovë-Tiranë,Shqipëri, për arsye angazhimi politik me lëvizjen VETËVENDOSJE, ne Kosovë duke lëvizur vajtje-ardhje mes Kosovës dhe Shqipërisë, adresa e vendqëndrimit Lëvizja Vetëvendosje, Rr. Behije Dashi, Nr.31, Prishtinë Kosovë
- Në vitet 2018-2019, ka jetuar në Prishtinë, Kosovë- Tiranë,Shqipëri, për arsye angazhimi politik me lëvizjen VETËVENDOSJE, ne Kosovë duke lëvizur vajtje-ardhje mes Kosovës dhe Shqipërisë, adresa e vendqëndrimit Lëvizja Vetëvendosje, Rr. Behije Dashi, Nr.31, Prishtinë, Kosovë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit, nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 1569 prot., datë 01.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1568 prot., datë 01.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin e propozuar nga zgjedhësit për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, z. Boiken Xhelal Abazi që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Përsa i përket ndalimeve të parashikuara në nenin 2, pika 2, të ligjit nr.138/2015, për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve , nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Në këto kushte me shkresën nr. 1658 prot., datë 03.03.2021, me lëndë kërkesë për verifikim më të thelluar, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Koordinimit Institucional, Sektorit të Dekriminalizimit, për verifikim të plotë të kandidatit e propozuar nga zgjedhësit për deputet z. Boiken Xhelal Abazi.

Gjithashtu me shkresën nr. 1771 prot., datë 08.03.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i ka dërguar sërish shkresë Prokurorisë së Përgjithshme, me lëndë informacion plotësues, sipas formularit të ridepozituar më datë 08.03.2021 nga z. Boiken Xhelal Abazi.



Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. 2228/1 prot., datë 04.03.2021 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin e propozuar nga zgjedhësit për deputet, z. Boiken Xhelal Abazi i cili rezulton se nuk ka shënime në sistem.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet z. Boiken Xhelal Abazi.

Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin e propozuar nga zgjedhësit për deputet z. Boiken Xhelal Abazi.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi për regjistrimin si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për deputet, z. Boiken Abazi, në zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 69, dhe 72 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 69, 71, 72 e 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe në shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,

#### **V E N D O S :**

1. Të regjistroj z. Boiken Xhelal Abazi si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për deputet, në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

